



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
SPORTIT DHE RINISË

BURSA STUDIMI NË PROGRAME MASTER DHE DOKTORATË JAPONI

VITI AKADEMIK 2019-2020

Ministria e Arsimit, Kulturës, Sportit, Shkencës dhe Teknologjisë (MEXT) e Japonisë ofron bursa për studentë të huaj të cilët dëshirojnë të studiojnë në universitetet japoneze. Qëllimi i bursave të ofruara nga MEXT është të nxisin burimet njerëzore të kontribuojnë në zhvillimin e të dy vendeve edhe më gjerë.

Aplikantët e interesuar duhet të aplikojnë për fushën e njëjtë ose të lidhur për të cilën ata kanë përfunduar studimet dhe të kenë lindur më ose pas **2 prill 1984**.

Informacioni për kushtet dhe kualifikimet e kërkuara nga pala japoneze për studimet Master ose Doktoratë, mënyra e plotësimit të formularit, gjenden në materialin bashkëlidhur.

Pas dorëzimit të formularit të aplikimit nuk lejohet ndryshimi në periudhën e mbërritjes. Nëse aplikanti nuk mund të mbërrijë në Japoni për periudhat e përcaktuara për arsye personale, shpenzimet e udhëtimit nuk do të paguhen.

Kujdes: aplikantët duhet të marrin një vizë "studentore" në misionin diplomatik japonez të vendosur në vendin e nënshtetësisë së aplikantit dhe të hyjnë në Japoni me statusin e "studentit".

Aplikantët duhet të dorëzojnë dokumentet e kërkuara sipas materialit bashkëlidhur në misionin diplomatik japonez të akredituar në vendin e tyre. Dokumentet e paraqitura nuk do të kthehen.

Informacioni lidhur me shpenzimet e ushqimit, të akomodimit dhe tarifën e shkollimit gjendet në materialin bashkëlidhur.

Për një informacion më të detajuar për mënyrën e aplikimit dhe të përgatitjes së dokumentacionit, ju lutemi referojuni materialeve informativë (bashkëlidhur) dhe adresës në web-site:

https://www.studyjapan.go.jp/pdf/applications/2019/2019_Guidelines_Research_E.pdf

https://www.studyjapan.go.jp/jp/smap_stopj-applications_research.html

https://www.al.emb-japan.go.jp/itpr_en/00_000142.html

DREJTORIA E INTEGRIMIT, KOORDINIMIT, MARRËVESHJEVE DHE ASISTENCËS